




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMI ORIENTUES
PËR PROVIMIN KOMBËTAR TË ARSIMIT BAZË
(PKAB)


LËNDA:
“GJUHË E HUAJ”


VITI SHKOLLOR 2025 – 2026
KOORDINATORE: LUDMILLA STEFANI



PËRMBAJTJA

1	HYRJE	3
2	UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT	5
3	STRUKTURA E TESTIT	6
4	REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI	8
5	TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA	10
6	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	12





1 HYRJE

Lënda “Gjuhë e huaj” është pjesë e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, një nga shtatë fushat e kurrikulës së arsimit bazë. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t’u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv, i pavarur dhe shkrues i saktë, origjinal dhe krijues.

Lënda “Gjuhë e huaj” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht) synon zhvillimin gjuhësor, kulturor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit duke e aftësuar në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale, intelektuale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës dhe të dijes.


Mësimi i gjuhës së huaj e ndihmon nxënësin të bëhet individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve nga fusha të ndryshme, nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar dhe niveli i njohurive i përket nivelit gjuhësor A2, sipas dokumentit Evropian “Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët dhe Volumi Shoqërues”.

Programi orientues për PKAB në lëndën “Gjuhë e huaj”, nëpërmjet përqendrimit në konceptet dhe shprehitë kryesore të mësuara gjatë viteve, ka si qëllim kryesisht të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesit e testeve përfundimtare për këtë provim.

Hartimi i programit orientues është mbështetur në kurrikulën me kompetenca të lëndës së gjuhës së huaj të arsimit bazë, duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe shprehive të domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale, si dhe arritjen e rezultateve të të nxënëtit për nivelin përkatës.


Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e testit për gjuhën e huaj është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.



Programi orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve dhe zhvillimet e tyre personale, me qëllim që t'u japë mundësi për sukses në provim.

Ky program synon:

- të ndihmojë nxënësit në përgatitjen e tyre për provimin e lirimit në gjuhën e huaj në nivelin gjuhësor A2, në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (CEFR), programin e klasës së nëntë të gjuhës së huaj të parë, si dhe tekstet me të cilat kanë punuar nxënësit gjatë ciklit 9- vjeçar;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve për mënyrën se si ta shfrytëzojnë këtë program dhe çfarë duhet të dinë ata për të realizuar me sukses këtë provim përmbyllës të dijeve të tyre në këtë lëndë;
- orientimin e vlerësimit që do të përfshijë dy aftësitë kryesore (nga katër aftësi që ka gjuhë e huaj) dhe dy koncepteve bazë që janë: “*Të lexuarit dhe të kuptuarit*” dhe “*Të shprehurit me shkrim*”;
- të japë orientime për specialistët në hartimin e testit për gjuhën e huaj.



2 UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT


Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, pasi nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, megjithëse tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program, nxënësit duhet të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program: ***Jeta e përditshme, Jeta shkollore, Jeta personale dhe shoqërore, Bota rreth nesh, Bota e komunikimit, etj.***

Për sa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore duke dalë nga konteksti i mësimeve ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me lloje ushtrimesh me alternativa, e herë lloje ushtrimesh të hapura.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore.

Për sa i përket të shkruarit, mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme kompozimi jo letrar (me tema të thjeshta). Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë paragrafë të saktë nga ana strukturore dhe leksikore. Gjithashtu, mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet personale në një tekst koherent. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur të shkruajë një email ose letër joformale dhe të zbatojë rregullat e shkrimit të një email-i, një letre joformale.




3 STRUKTURA E TESTIT

Lënda e gjuhës së huaj është organizuar mbi kompetencën komunikuese, realizimi i të cilës përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës së gjuhës së huaj ndihmon nxënësin:

- të zhvillojë konceptet bazë gramatikore, ortografike, leksikore etj.;
- të përzgjedhë fjalorin e duhur në kontekste të ndryshme shoqërore;
- të njohë dhe të zbatojë rregullat dhe parimet sipas të cilave mesazhi gjuhësor organizohet dhe strukturohet;
- të përzgjedhë dhe të zbatojë strategjitë e duhura në përcimin e mesazhit.

Nëpërmjet testit të lëndës së gjuhës së huaj në PKAB, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e kompetencave të lëndës gjuhë e huaj.


Kompetencat e lëndës “gjuhë e huaj”	Përshkrimi i kompetencave
Kompetencia gjuhësore	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • prodhon shprehje të shkurtra të përditshme për të plotësuar nevoja të thjeshta konkrete: detaje personale, rutina e përditshme, dëshirat dhe nevojat, kërkesa për informacion; • përdor modele fjalish bazë, komunikon me shprehje të memorizuara dhe grupe fjalësh rrëth vendeve dhe njerëzve të tjere, çfarë bëjnë ata etj; • ka një repertori të kufizuar të shprehjeve që mban mend rrëth situatave që kanë të bëjnë me parashikimet, keqkuptimet që ndodhin në rrëthana jo rutinë; • zotëron dhe kontrollon fjalor të mjaftueshëm për të shprehur nevojat bazë të komunikimit dhe për të përballuar nevojat e thjeshta të mbijetesës; • përdor struktura të thjeshta në mënyrë korakte, por në mënyrë sistematike bën gabime bazë, si p.sh., ka tendencë të ngatërrojë



	<p>kohët e foljeve dhe harron të bëjë përshtatjet; megjithatë zakonisht është e qartë se çfarë ai po përpinqet të thotë;</p> <ul style="list-style-type: none">• kopjon fjali rrëth temave të përditshme, p.sh., shpjegime si të shkojë diku, shkruan me saktësi fonetike fjalë të shkurtra që janë pjesë të fjalorit të tij.
Kompetenca Socio-gjuhësore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• menaxhon shkëmbime shumë të shkurtra informacioni shoqëror duke përdorur përshëndetje shprehje të përditshme të mirësjelljes;• mund t'ju përgjigjet ftesave, sugjerimeve etj.
Kompetenca pragmatike	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• zgjeron shprehjet e mësuara nëpërmjet një kombinimi të thjeshtë të elementeve të tyre;• tregon një histori ose përshkruan diçka duke u bazuar në një listë të thjeshtë çështjesh;• bashkon grupe fjalësh me lidhëza të thjeshta si “dhe”, “por” dhe “sepse”.

Përbushja e kompetencave gjuhësore që një nxënës duhet të zotërojë përgjatë zhvillimit të lëndës, arrihet nëpërmjet veprimitarive që nxënësi kryen gjatë përdorimit të gjuhës të cilat janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera.

Aftësitë gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar	50%
Përdorimi i drejtë i gjuhës (gramatika dhe leksiku)	30%
Të shkruarit	20%



4 REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar

Përshkrimi


Nxënësi kupton tekste të shkurtër dhe të thjeshtë të hartuar kryesisht në një gjuhë të përditshme dhe me fjalor të një frekuence të lartë. Mund të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, shprehjen e ndjenjave dhe të urimeve në letra personale.

Nxënësi:

- lexon tekste që përbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njojur nga fondi bazë i gjuhës së huaj;
- kupton një mesazh të thjeshtë, si sms, e-mail, etj.;
- kupton letra personale të thjeshta;
- dallon të dhëna personale në një pyetësor;
- identifikon mesazhe, komente të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë;
- lexon dhe kupton tekste të thjeshta me gjuhë jo shumë të ngarkuar;
- dallon informacionin bazë dhe disa detaje në një tregim që trajton temë të njojur me fjalor përgjithësisht të trajtuar më parë;
- identifikon mesazhin kyç në njoftime, faqe interneti etj.;
- kupton shenjat dhe lajmërimet në vende publike si p.sh në hotel, restoran, stacion treni etj.;
- identifikon informacionin specifik në broshura dhe artikuj të shkurtër gazetash ku përshkruhen ngjarje;
- kupton udhëzime të thjeshta për përdorimin e pajisjeve të përdorimit të përditshëm, si p.sh., telefoni, televizori etj.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi



Nxënësi përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të mësuara gramatikore duke i përdorur ato saktë dhe pa gabime ortografike.

Nxënësi:

- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme;
- zgjedhon folje të rregullta dhe të parregullta, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna;
- përdor përemrat lidhorë;
- përdor mbiemrat cilësorë, pronorë, dëftorë etj.;
- përdor ligjëratën e drejtë dhe atë të zhdrojtë;
- përdor fjali të thjeshta në formën jo veporre;
- përdor fjali të thjeshta kushtore.


Të shkruarit

Përshkrimi

Nxënësi shkruan tekste të shkurtër dhe letra personale mbi tema të jetës së përditshme. Nxënësi përdor fjali dhe shprehje të thjeshta të lidhura me lidhëzat “dhe”, “por”, “sepse”.

Nxënësi:

- shkruan një mesazh ose një letër të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje;
- përshkruan në një letër personale familjen, vendin ku banon, kohën dhe me se merret;
- përshkruan një person duke dhënë detaje për veshjen, karakterin etj.;
- përshkruan itinerarin e një udhëtimi;
- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;
- përshkruan thjeshtë atë që dëshiron të bëjë në një të ardhme të afërt ose të largët si: shkollën që dëshiron të ndjekë, profesionin që do të ushtrojë etj.;
- përshkruan thjeshtë njerëzit, vendin, punën, studimet etj.;
- përshkruan thjeshtë atë që i ka ndodhur në një të shkuar të largët ose të afërt.



5 TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar

Përshkrimi

Vlerësimi i kësaj aftësie do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë jo letrare. Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim të shprehur me gjuhë të thjeshtë mbi atë çka i kërkohet.


- Pyetje mbi përbajtjen e tekstit.
- Ushtrime me përzgjedhje fjalësh ose frazash.
- Plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur.
- Ushtrime me përgjigje *po/jo*.
- Ushtrime me disa alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat).
- Ushtrime ku kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve.
- Ushtrime të tipit e saktë /e pasaktë.
- Bashkimi i elementeve të dy kolonave.
- Gjetja e një informacioni në një tekst.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi

Njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, do të testohen përmes ushtrimeve që trajtojnë njësi të ndryshme gramatikore ose leksikore, pra kryesisht fjalori dhe gramatika e mësuar.

- Ushtrime me zëvendësim, zëvendësimi i një fjalë me të ngjashmen e saj.
- Ushtrime me shumë zgjedhje/alternativa.
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh.



- Vendosja e fjalës së duhur në fjali.
- Ushtrime me kombinime.

Të shkruarit


Përshkrimi

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi temat e trajtuara në program duke i lidhur elementet përbërës në mënyrë koherente, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime jo shumë të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të pangarkuar me detaje, të shkruajë një letër personale, një email joformal duke respektuar formatet e mësuara gjatë viteve që nxënësi ka studiuar këtë gjuhë etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **60-80 fjalësh**. Nxënësi vlerësohet për përmrbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore, strukturën e rrjedhën logjike.

Të shprehurit me shkrim përfshin të shprehurit me shkrim në formën e një përshkrimi, letre etj., për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar ndër vite, në nivelin A2.

- Shkrimi i një *email-i*, ku i tregohet një mikë rrëth një përvoje që ka lënë mbresa etj.;
- Shkrimi i një letre jo formale.
- Letër personale e thjeshtë.
- Letër falënderimi.
- Email.
- Ftesa.
- Mesazhe.
- Përshkrime të thjeshta ngajeta e përditshme si: njerëz, vende, ngjarje.




6 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Nxënësit në provim do të përballet me situata ose pjesë të reja leximi por *tematika, gramatika* dhe *funkzionet gjuhësore* do të jenë ato që nxënësit kanë studuar për këtë nivel gjuhe (A2).

Tematikat me të cilat do ndeshen nxënësit në këtë provim do të përfshijë temat bazë sipas kurrikulës dhe Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët, i cili së bashku me Portofolin European të Gjuhëve janë materialet referues për të gjitha gjuhët që mësohen në sistemin tonë parauniversitar. (*Më poshtë jepen disa shembuj të tematikave dhe koncepteve leksikore dhe gramatikore në disa gjuhë të huaja*).

- **Jeta e përditshme** (koha e lirë, aktivitetet e moshës, planifikimi i kohës, agjenda, sporti, ushqimet, të dhëna personale, plane personale etj.).
- **Jeta shkollore** (planifikimi i udhëtimeve me klasën, rregullat në shkollë, mësimi në shkollë etj.)
- **Jeta personale dhe shoqërore** (probleme të adoleshencës, festat, personaliteti, marrëdhëni shoqërore, dëshirat etj.).
- **Bota rreth nesh** (udhëtimet dhe turizmi, kultura, kujdesi për planetin, çështje, përgjegjësitet shoqërore, komuniteti etj.).
- **Bota e komunikimit** (shkenca dhe teknologjia, shpikje dhe zbulime, telefoni, radio, muzika, çështje aktuale).

Gjuhë angleze
<ul style="list-style-type: none">• <i>family</i>• <i>arts(music, picture, sculpture, cinema)</i>• <i>sports and entertainments</i>• <i>technology</i>• <i>travel</i>• <i>environmental issue, world issues</i>• <i>modern living, etc.</i>• <i>cultural exchanges</i>
Gjuhë frëngje




- *la maison et l'environnement*
- *l'école et l'éducation*
- *les voyages*
- *les loisirs*
- *la vie quotidienne*
- *les relations interpersonnelles*
- *les achats*
- *la santé*
- *la météo*
- *les moyens de communication.*

Gjuhë italiane

- *usanza, costumi, cucina, sport, preferenze personali, interessi*
- *il mondo intorno a noi, viaggi, shopping, posti famosi ecc*
- *studi e lavoro*
- *vita personale e sociale*
- *la comunicazione (TV, reality shows, film, lettere, e-mail).*

Gjuhë gjermane

- **Erlebnisbereich ‘Ich als Person’.** (*Persönliche Daten, Lebenslauf, Aussehen und Geschmack, Gesundheit, Krankheit, Kleidung, Tagesablauf, Hobbys und Freizeit.*)
- **Erlebnisbereich ‘Unmittelbare Umgebung’.** (*Familie, Freunde und Bekannte, Nachbarn, ‘Familie’ definieren/ Familienaufgaben, Eine kleine oder eine grosse Familie haben? - Rollenverteilung, Familienfeste und Geschenke, Essen und trinken, Wohnung, Umzug und Einrichtung, Jugend und ihre Probleme / Jugend ‘definieren. Sport und Fitness, Die Liebe hat keine Grenze- Liebeskummer, Träume und Eünsche definieren, Auf dem Land /in der Stadt.*)
- **Erlebnisbereich ‘Weitere Umgebung’.** (*Fremd(e), Reise – Impressionen / Reisepläne, Urlaub, Heimat: Was ist Heimat? Einen Begriff umschreiben, Kommunikation, Lebensstationen, Schule und Schulerfahrungen, Ausbildung und Berufsseuge, Arbeitsseelt*)



(und Karriere, Warenëelt.)

- **Vermittelte Erlebnisbereich.** (*Massenmedien, Nachrichten und Berichte, Medien und Werbung – Mit Medien durch den Tag, Sprachunterricht mit/ohne Medien, Landeskunde und interkulturelles Lernen, Das eigene Land, Deutschsprachige Länder, Aus der Politik und Geschichte*)

Përdorimi i gjuhës do trajtojë gramatikën dhe leksikun e Nivelit A2.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen nëpërmjet ushtrimeve të ndërtuara si bashkëbisedime në situata të thjeshta të jetës së përditshme duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore.


Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto situata gjuhësore.

Gjuhë angleze

- *greeting people*
- *introducing yourselves and others*
- *introducing your family*
- *describing places, events, holiday activities, etc.*
- *describing clothes*
- *likes and dislikes*
- *inviting someone in a special event or a party*

Gjuhë frëngje

- *demander et donner des explications, des informations*
- *donner et demander un avis, une opinion, p.ex.: je pense que, je crois que, ...*
- *décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement*
- *raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements, p.ex.: d'habitude... chaque matin, d'abord..., après..., à la fin... etc.*
- *exprimer le but (pour + inf.)*
- *exprimer la condition et l'hypothèse*
- *rapporter les paroles de quelqu'un*





Gjuhë italiane

- *esprimere interessi o preference*
- *permettere e proibire*
- *chiedere e dare informazioni*
- *esprimere opinioni; accettare o rifiutare*
- *prendere decisioni*

Gjuhë gjermane

- *eigene Meinungen äussern: meiner meinung nach...; Ich bin mir sicher dass...;*
- *ich würde sagen ...; usë*
- *vermutungen, Behauptungen formulieren: Ich behaupte...; Ich vermute...; Ich glaube...; Kann sein dass...; Èahrscheinlich...; usë*
- *sich pro und kontra äussern: Ich stimme zu; Ich bin dafür; Ich bin völlig dagegen. usë*
- *über eigene Erfahrungen berichten. Über ereignisse in der vergangenheit berichten*
- *etëas Irreales ausdrücken*
- *ratschläge geben., um rat bitten*
- *gefallen, missfallen ausdrücken*
- *gefühle ausdrücken, èünsche äussern, glückeünsche aussprechen*
- *informieren und nachfragen*
- *etëas begründen, etëas beurteilen, etëas beëerten, vergleichen, Verständnis zeigen, erstaunt oder kritisch reagieren*





Elementet dhe strukturat gramatikore


Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqendruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuar.

Gjuhë angleze

- *verb tenses(present simple, past simple, present perfect, future tense)*
- *simple uses of articles*
- *plurals of nouns*
- *adjectives*
- *adverbs of frequency*
- *prepositions of place and time, etc;*
- *present and past passive*
- *simple phrasal verbs*
- *first conditional*

Gjuhë frëngje

- *le présent des verbes du premier, deuxième groupe et des verbes irréguliers*
- *l'imparfait et le passé composé*
- *le futur*
- *le conditionnel présent*
- *le gérondif*
- *l'impératif*
- *le plus-que parfait*
- *la forme passive*
- *les expressions de la durée (depuis, pendant, il y a ...)*
- *le discours rapporté au présent*
- *complément d'objet direct*
- *complément d'objet indirect*
- *la place des deux pronoms: ex. Je le lui donnerai*
- *les pronoms relatifs simples (qui, que, dont, où)*




- les pronoms: *y* et *en*
- le comparatif et le superlatif
- l'article défini, l'article indéfini, et l'article partitif
- l'accord, le genre et la place de l'adjectif
- l'adjectif et le pronom possessif
- l'adjectif et le pronom démonstratif
- l'adjectif et le pronom interrogatif
- l'adjectif et le pronom indéfini

Gjuhë italiane

- tempi: (*Presente, passato prossimo, futuro semplice, futuro anteriore, imperfetto, condizionale*)
- gerundio semplice
- imperativo diretto
- condizionale presente
- pronomi personali
- verbi modali
- aggettivi qualificativi
- preposizioni semplici e articolate
- avverbi di modo
- congiunzioni

Gjuhë gjermane

- verb: *Präsens*
- *perfekt, Präteritum*
- *futur I, plusquam perfekt*
- *passiv*
- *konjunktiv II*
- *regelmässige, unregelmässige Verbena*
- *trennbare Verbena*



- *modalverben*
- *partizip I und II*
- *unbestimmter, bestimmter artikel, negativartikel, frageartikel*
- *substantiv: singular, plural*
- *deklination des substantivs*
- *adjektiv: adjektivideklation und graduierung*
- *prädikativ, attributives adjektiv*
- *verb und ergänzungen, akkusativ - und dativergänzung: stellung im satz*
- *infinitiv mit zu*
- *präpositionen mit akkussativ, dativ, genitiv, eechselpräpositionen*
- *präpositionaladverbien*
- *verben mit reflexivpronomen*
- *possessivartikel*
- *demonstrativartikel: dieser, dieses, diese*
- *indefinitpronomen*
- *nebensätze:/ kausalsätze*
- *temporale nebensätze*
- *konsekutivsätze / finalsätze / konzessivsätze*
- *relativsatz / relativpronomen*
- *konditionalsatz*
- *temporal – kausal – modal – lokalangaben*
- *verben mit präpositional – ergänzungen*
- *funktionsverb – gefüge*
- *öortbildung: substantive aus verbena*
- *imperativ*
- *konjunktionen*
- *direktionaladverbien*
- *ordinalzahlen*